

TESS, VICTIM OF HYPOCRISY TESS OF THE d'URBERVILLES, THOMAS HARDY**Suzana Ibraimi Memeti**State University of Tetovo, Macedonia, suzana.ibraimi@gmail.com

Abstract: Thomas Hardy is distinguished by his contemporaries for the fact that the subjects of his novels are taken from the rural environment in the agricultural region south of England. He calls his homeland Dorset, Wessex, in memory of former King Alfred the Great. Themes and subjects of his novels are attractive and dominant. In all of his most popular novels, Hardy describes, outlines, and portrays human beings who are faced with powerful attacks of devastating and mysterious forces. He was a serious novelist who sought to present the view of life throughout a novel. Frequently, his themes and subjects mix with the sequence of events that have extreme and fatal consequences, while he rarely fails to inspire the reader with his deep mercy to the characters who suffer in their lives; he often cannot afford to reach the highest degree of tragic element. The author sends an indictment to his time: he firmly rejects the duality of morality according to which the behavior of a man and the behavior of a woman is differently estimated. Thomas Hardy's world as a writer is completely realistic, even transparent because he is a rare master of description of the environment. His characters are creatures of their environment, presented in their mutual relationships, often with sharp psychological observations. "Tess of the d'Urbervilles" is based on a familiar motif, that of a fallen woman, where Tess represents the prejudices of the Victorian society. In the novel, Hardy portrays an innocent poor girl of a country, a victim of the combined forces of Victorian patriarchal society, of the hypocrisy of social prejudice and gender inequality, which shows his deep sympathy for Tessa, the protagonist of the novel, a symbol of women devastated without mercy in a world dominated by males. He shows that Tess is an example of the devastating effect of society's pressures on a pure girl, and that Angel and Alec are personifications of destructive attitudes towards women.

Keywords: Tess, moral, hypocrisy, inequality, society.

TESA, VIKTIMË E MORALIT HIPOKRIT TESA E DUBËRVILLËVE, TOMAS HARDI**Suzana Ibraimi Memeti**State University of Tetovo, Macedonia, suzana.ibraimi@gmail.com

Abstrakti: Hardi dallohet nga bashkëkohësit e tij për faktin se temat e romaneve të tij janë marrë nga mjedisi fshatar në rajonin bujqësor në jug të Anglisë. Vendlindjen e tij Dorsetin e quan Ueseks, për kujtim të mbretit të dikurshëm Alfredi i Madh. Temat dhe subjektet e romaneve të tij janë tërheqëse dhe dominante. Në të gjitha romanet e tij më të njohura ai përshkruan, përvijon, dhe portretizon qeniet njerëzore të cilët ballafaqohen me sulme të fuqishme të forcave të liga, shkatërrimtare dhe misterioze. Ai ishte një romancier serioz i cili orvatej të paraqiste përmes romanit pikëpamjen mbi jetën. Të shpesh të herës, temat dhe subjektet e tij përzihen me vazhden e ngjarjeve që kanë pasoja të skajshme dhe fatale, prandaj, ndërsa ai rrallë dështon që t'i frymëzojë lexuesit me mëshirën e tij të thellë për personazhet që vuajnë në jetë, ai shpesh nuk ia del dot që të arrijë shkallën më të lartë të elementit tragjik. Autori i dërgon një akuzë kohës së tij: ai e hedh poshtë me vendosmëri dyfytërsinë e moralit sipas të cilit vlerësohet ndryshe sjellja e mashkullit dhe ndryshe sjellja e femrës. Bota e Tomas Hardit si shkrimtar është plotësisht reale, madje edhe transparente sepse ai është mjeshhtëri i rrallë i përshkrimt të ambientit. Personazhet e tij janë krijesa të ambientit të tyre, të paraqitur në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, shpesh herë edhe me vrojtme të mprehta psikologjike. "Tesa e Dubërvilëve" është i bazuar në një motiv të njohur, atë të një gruaje të rënë, ku Tesa përfaqëson paragjykimet e shoqërisë viktoriane. Në roman, Hardy portretizon një vajzë të varfër të pafajshme të vendit, viktimë nga forcat e kombinuara të shoqërisë patriarkale viktoriane, nga hipokrizimi i paragjykimeve sociale dhe pabarazia gjinore, i cili tregon simpatinë e tij të thellë për Tesën, protagoniste e veprës, simbol i grave të shkatërruara pa mëshirë në një botë të dominuar nga meshkujt. Ai tregon se Tesa është shembull i efektit shkatërrues të presioneve të shoqërisë mbi një vajzë të pastër dhe të panjollë dhe se Engjëlli dhe Alek janë personifikime të qëndrimeve destruktive ndaj grave.

Fjalë kyçe: Tesa, morali, hipokrizimi, pabarazi, shoqëri.

HYRJE

Romanet e Hardit paraqesin jetën e zyrtë të shtresës së ulët në vendlindjen e tij në Ueseks. Së këndejmi, romanet e tij ai i quajti “romane rajonale”. Ky lloj i romanit filloi të shkruhej në anglishte që nga viti 1870, por Hardi i solli një intensitet si pejzazhist ashtu edhe personazheve që u dhanë romaneve veçorin e mitit. Trashëgimia letrare me tematik fshatarake është e qartë. Romanet e Hardit kanë një lloj afiniteti me “mjeshtërinë e vrazhdë” në veprat e Shekspirin, ndërsa stoicizmi i tyre na rikujton Uordsuorthin, kurse trualli dhe sfondi i ngjarjeve është njësoj si i Skotit. Villiem Barnsi, një poet nga Dorseti, dha kontribute për diskursin dhe veprimtarinë e personazheve. Natyrisht, Hardi i kishte përvijuar personazhet e tij me kohë. Në një ese të botuar në “The Dorsetshire Labourer” më 1883, ai paraqet tabllonë e tyre jo sentimentale:

“Ata janë një numër i konsiderueshëm i krijesave të ndryshëm, burra me shumë mendime; kanë dallime të mëdha; disa janë të lumtur, disa të vetmuar dhe të qetë, e disa të tjerë janë të zhgënjyer; ka në mes tyre edhe ndonjë gjeni, ndonjë të krisur, ndonjë tekanjok dhe ndonjë burrë të vrazhdë. Secili prej tyre ecën në shtegun e tij për të arritur te vdekja”. Nga të gjitha këto sqarime, Hardi përvijoi pothuajse vizionin e një drame. Personazhet e tij veprojnë por edhe të tjerët veprojnë mbi ta, mirëpo ata e shkojnë jetën duke u mbështetur në kushtet e tyre që i gllabërojnë ata. Në marrëdhëniet me njeri-tjetrin, ata janë të ndershëm, bujarë, të shoqërueshëm dhe tolerantë; disa prej personazheve janë të zhytur në besëtytni dhe besojnë se fati ndikon në jetën e tyre, nëse ata sillen me arrogancë. Ata përpiqen të jetojnë në harmoni me disa kërkesa të tyre modeste, duke i përgojuar të tjerët të cilët nuk kanë pikëpamje të njëjtë me ta.

TRUPI

“Tesa e Dubëvilëve” u botua në vitin 1891. Tema e këtij romani është epike. Kësaj radhe autori e shtjellon dëshirën dhe qëllimin e paplotësuar, sepse shpesh herë ai ka pasur dilema për ç’arsye burri i gabuar merr një grua të rëndomtë, kurse gruaja e gabuar gjen një burrë të zakonshëm. Me këtë rast autori vëren: “Filozofia analitike shqyrton këtë me mijëra vjet por nuk mund ta sqarojë këtë çështje”. Tesa dallohet nga romanet tjerë sepse ka një qëllim shoqëror prandaj edhe nëntitulli i romanit është “Një grua e pastër”. Jo vetëm fati i lig dhe keqbërjet e njerëzimit, po edhe normat konvencionale të shoqërisë, ishin shënjestra e kritikës së autorit. Vërtetësia e përshkrimit të ngjarjeve dhe karaktereve në roman, gjatë të tetëdhjetave dhe të nëntëdhjetave të shekullit XIX, ishte një kërkesë estetike shumë e rëndësishme. Duke përshkruar përshkëndetjen e Tesës dhe pasojat që pati ajo, Hardi nuk kishte shtruar ndonjë temë të re, meqë këtë temë e kishin shfrytëzuar edhe shkrimtarë të tjerë me një liri më të madhe. Mirëpo, duke e bërë Tesën heroinë të romanit, duke i ndriçuar dhe sqaruar ngritjet dhe rëniet e saj në jetë, ai synonte ta kritikonte parimin maltuzian dhe të krishterë, sipas së cilit, një vajzë e cila lind një fëmijë të paligjshëm, ndoshta mund të zgjojë ndonjë mëshirë. Por, ajo trajtohet si fajtoreshë.

Hardin kritikët e kanë quajtur shpesh herë romancier poetik, sepse në romanet e tij ka edhe fragmente të prozës poetike, ndërsa vet Hardi është marrë me poezi tërë jetën. Në kohën kur idetë që kishin gjasa ta zhvillonin realizmin psikologjik, Hardi ishte i prirur më tepër që t’i injoronte kufizimet e përditshme. “Nuk janë të rëndësishme pamundësitë e ngjarjes, por janë të rëndësishme pamundësitë e personazhit,” ka shkruar Hardi më 1886. Por edhe sikur të ishte e vërtetë kjo, personazhet e Hardit i kanë tiparet dhe cilësitë e tyre dhe jetojnë e veprojnë në një botë ku elementet shoqërore kanë sjellë marrëdhënie të reja me ndërthurje domethënëse të ngjarjeve, në një peisazh plot jetë dhe plot ideale (Albert, 434-438).

Pasi Xhon Darbevillit, një fshatar, merr vesh se e ka prejardhjen nga një familje e pasur, ai shkon në kafenen e fshatit dhe dehet nga gëzimi. Herët në mëngjesin tjetër, Tesa, bija e tij e dëgjueshme, nis për të shkuar në pazar, por atë e zë gjumi në karrocë, ndërsa kali i familjes vritet aksidentalisht. Familja e dërgon Tesën që të kërkojë punë tek zonja Darbevill, një grua e pasur, për të cilën familja e Tesës mendon se është farefis me familjen e lashtë prej nga mund ta kenë prejardhjen të dy familjet. Familja e Tesës nuk e di se familja tjetër Darbevill e ka blerë këtë mbiemër me qëllim që të paraqitet si një familje e re dhe e pasur, me origjinë aristokratike nga Stouksi, Anglia veriore. Ndërkaq, bukuria e Tesës i lë përshtypje Alek Darbevillit, i cili i ofron asaj punë. Gjatë disa muajve, Aleku i vardiset Tesës, dhe më në fund e çnderon në një pyll të errët. Ajo mbetet në shtëpinë e tij me të për disa javë para se të kthehet në shtëpinë e saj.

Ndërkohë, Tesa lind një fëmijë, por fëmija vdes pas disa ditësh, kështu që Tesa është e shtrënguar që ta varrosë vetë atë. Pas një viti të kaluar në shtëpi, Tesa bëhet një mjelëse në baxhon e fermës blektorale të Tallbothejit, ku njihet me një djalë të ri që i lë përshtypje asaj. Ky djalosh i kulturuar dhe intelektual quhej Engjëlli Kler dhe punonte aty si praktikant për t’u bërë fermer. Ai bie në dashuri me Tesën, për arsye se i pëlqen bukuria dhe pastërtia e saj. Tesa fillimisht e refuzon Engjëllin, por më pas pranon të martohet me të. Pak para martesës ajo përpiket më kot t’i tregojë atij të kaluarën e saj. Një natë pas dasmës, sipas një marrëveshjeje në mes tyre, Engjëlli i rrëfen Tesës të

kaluarën e tij. Tesa ia falë mëkatet, por kur Tesa i tregon Engjëllit të kaluarën e saj me Alekun, Engjëlli tronditet shumë dhe nuk ia falë Tesës. Ai e braktis Tesën, por duke i lejuar asaj që nëse do të kishte ndonjë problem financiar, t'i drejtohej familjes së tij.

Pastaj, Engjëlli shkon në Brasil për të blerë një fermë. Kurse Tesa gjen një punë dimërore në një fermë bujqësore me kushte shumë të vështira, ku ajo dhe shoqet e saj trajtohen tejet brutalisht. Tesa vendosë t'i vizitojë prindërit e Engjëllit. Por, para se t'i vizitonte, ajo përgjoi rastësisht një bisedë në mes vëllezërve të Engjëllit të cilët flisnin keq për martesën e gabuar të Engjëllit. Duke u kthyer në shtëpi, Tesës i afrohet një prift, i cili në të vërtetë ishte Alek Dabervilli. Pas largimit të Tesës nga ai, Aleku i penduar kishte vendosur të bëhej prift. Mirëpo, kur e sheh Tesën, i ringjallet pasioni i tij për të dhe e harron se është bërë shërbyes i Zotit. Aleku përsëri i bie pas Tesës, i vardiset, i bën lajka dhe i lutet që të kthehet tek ai. Përveç kësaj, ai i jep të holla familjes së Tesës dhe i rikujton Tesës se burri i saj nuk po e mbron dhe e ka harruar atë. Pas vdekjes së të jatit dhe pasi familja e saj mbetet pa strehë, Tesa i dorëzohet Alekut.

Ndërkohë, Engjëlli ishte shëruar nga ethet në Brasil, dhe vendos të kthehet në Angli te nusja e tij. Mirëpo, kur e takon atë në Santburn, ai e ka të qartë se Tesa ishte kthyer tek Aleku dhe se ai kishte arritur shumë vonë. Engjëlli i pikëlluar shëtit rrugëve të fshatit, interesohet se ku e ka banesën Tesa. Ai e gjen shtëpinë ku banonte ajo, por i zoti i shtëpisë e njofton se Tesa nuk ishte aty dhe se në dysheme kishte gjetur pika gjaku që dëshmonin se Tesa e kishte vranë Alekun.

Fjala për vrasjen e Alekut u përhap menjëherë dhe Tesën kësaj radhe filloi ta ndjek ligji. Engjëlli dhe Tesa takohen më në fund dhe kalojnë disa ditë të lumtura së bashku në një vilë të pabanuar. Duke u përpjekur për t'u fshehur nga policia, ata kalojnë një natë të bukur në gërmadhat e Stonhengjit, mirëpo në mëngjes policia e rrethon monumentin antik dhe e arreston Tesën. Në ekzekutimin e saj marrin pjesë vetëm Engjëlli dhe motra e vogël e Tesës.

PËRFUNDIMI

“Tesa e Dubëvilëve” është i bazuar në një motiv të njohur, atë të një gruaje të rënë, ku Tesa përfaqëson paragjykimet e shoqërisë viktoriane. Në roman, Hardy portretizon një vajzë të varfër të pafajshme të vendit, viktimë nga forcat e kombinuara të shoqërisë patriarkale viktoriane, nga hipokrizimi i paragjyqimeve sociale dhe pabarazia gjinore, i cili tregon simpatinë e tij të thellë për Tesën, protagoniste e veprës, simbol i grave të shkatërruara pa mëshirë në një botë të dominuar nga meshkujt. Fati tragjik i Tesës është i lidhur ngushtë me tradhëtinë e dy burrave. Hipokrizimi borgjez dhe dominimi mashkullor mëshirojnë Engjëllin dhe Alekun mirëpo dërgojnë Tesën në shkatërrim. Në botën konvencionale me një pamje të ashpër mbi virgjërinë dhe dëlirësinë, ndjenja e vetë-fajësisë dhe vetë-turpërimit e përcjell atë gjatë jetës së saj. Pas shkeljes seksuale, shoqëria e ngurtë nuk i jep asaj asnjë shans për rigjenerimin. Hardy tregon simpati ndaj heroinës, ku thekson se fati i mjerë i Tesës dhe tragjedia e saj janë rezultat i shoqërisë patriarkale. Ai tregon se Tesa është shembull i efektit shkatërrues të presioneve të shoqërisë mbi një vajzë të pastër dhe të panjollë dhe se Engjëlli dhe Alek janë personifikime të qëndrimeve destruktive ndaj grave.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Adams, J. Eli. *A History of Victorian Literature*, Clichester West Cambridge, 2012.
- [2] Aitken, J. Lyall, *Masques of Morality: Females in Fiction*, Toronto: The Women's Press, 1987.
- [3] Albert, E. A. *History of English Literature*, Hong Kong, 1985. Cobbe, Frances. *Criminals, Idiots, Women and Rumors in Fraiser's Magazine*, in 1903.
- [4] Colby, Vineta. *Yesterday Women, Domestic Realism in the English Novel*, Princeton, New Jersey, 1974. Cruttendan, Aidan. *The Victorians, Facts and Files*, London 2003.
- [5] Cvetkovich, Ann. *Mixed Feelings, Feminism, Mass Culture and Victorian Sensationalism*, Piscataway. New Jersey, Rutgers UP, 1992.
- [6] Cunningham, Gail. *The New Woman and the Victorian Novel*. London: Macmillan Press, 1978.
- [7] Daiches, David. *A Critical History of English Literature, Volume II*, London, Secker and Warburg, 1963.
- [8] Damrosch, David Ed., *The Longman Anthology of British Literature*, New York, Addison Wesley Educational Publishers Inc., 2003. Mee, Jon (2010). [The Cambridge Introduction to Charles Dickens](#). Cambridge Introductions to Literature. [Cambridge University Press](#). ISBN 978-0-521-67634-2. Retrieved 24 April 2012.
- [9] Mitchell, Hannah. *The Hard Way Up, The Autobiography of Hannah Mitchell Suffragete and Rebel*, London, 1968.

- [10] Moers, Ellen. *Literary Woman*, London, 1977.
- [11] Morris, Virginia. *Double Jeopardy Woman Who Kill in Victorian Fiction?*, Lexington UP of Kentucky, 1990.
- [12] Nield, Keith. *Prostitution in the Victorian Age, Debates on the Issues from Nineteenth Century Critical Journals*, London, 1973.
- [13] Nord, Epstein. *walking in the Victorian Streets, Women Representation and the City*, London, Cornell UP, 1995.
- [14] Thomas Hardy, "*Tess of the D'Urbervilles*"
- [15] Walkowitz, Judith. *Prostitution and Victorian Society, Women, Class and the State*, New York, 1990.
- [16] Watt, George. *The Fallen Women in the Nineteenth Century English Women*, London, 1984.
- [17] Westport, CN and London: Greenwood P, 2004, 96-100. (Ruth)
- [18] Whitson, Kathy J. "Elizabeth Gaskell." *Encyclopedia of Feminist Literature*.